



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. 52 / 4 prot.

Tiranë, më 06.10.2022

VENDIM

Nr. 911, Datë 06.10.2022

**“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË
VENDIMIT NR. 693, DATË 14.05.2020 “PËR KONSTATIMIN E ABUZIMIT ME
POZITËN DOMINUESE TË FEDERATËS SHQIPTARE TË FUTBOLLIT, NË
LIDHJE ME AKTIVITETIN EKONOMIK QË ZHVILLON, DHE DHËNIEN E
KUSHTEVE DHE DETYRIMEVE”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.10.2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbyllja e procedurës së monitorimit të zbatimit të vendimit nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe neni 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 4, neni 8, neni 9 dhe neni 42 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003) me Vendimin nr. 564, datë 25.10.2018, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon për periudhën kohore 2015-2018.
2. Në përfundim të hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës konkludoi se nga analiza e sjelljes së FSHF në tregjet përkatëse konstatohet: (i) Shitja e të drejtës audiovizive tek një operator i vetëm për një periudhë të gjatë 7 vjet, duke përfshirë në një paketë të vetme të gjithë të drejtat ekskluzive, duke u bërë përjashtuese për operatorët e tjerë; (ii) çmime të shitjes së biletave të larta krahasuar me rajonin, të pa mbështetura në një metodologji të

miratuar, të cilat mund të kufizojnë konkurrencën në kuptim të nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003.

3. Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës në zbatim të ligjit nr. 9121/2003, me Vendimin nr. 607, datë 01.04.2019, vendosi “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën kohore 01.01.2015 deri në 31.12.2018.
4. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 632, datë 20.06.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 607, datë 01.04.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit”, vendosi të bëjë ndryshimin për zgjatjen e afatit: Hetimi i Thelluar do të përfshijë periudhën kohore nga 01.01.2015 deri në 30.04.2019.
5. Në përfundim të hetimit të thelluar, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”, ka vendosur:
 - i. Konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të FSHF si entiteti i vetëm të cilit shteti i ka deleguar të drejtën e organizimit dhe zhvillimit të veprimtarive sportive, kombëtare e ndërkombëtare në sportin e futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, në drejtim të shitjes së të drejtave të transmetimit televiziv; shitjes së biletave të ndeshjeve të ekipeve kombëtare; sponsorizime dhe reklama.
 - ii. Dhënien e kushteve dhe detyrimeve për të ndaluar abuzimin me pozitën dominuese të FSHF:
 - a. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprim dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhe jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t’u shiten operatorëve të ndryshëm.
 - b. Detyrimin e FSHF në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që ato të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve audioviziv.
 - c. Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “Highlighte” dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të gjerë për operatorët audioviziv.
 - iii. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtë televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.
 - iv. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publik në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.

- v. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publik në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.
 - vi. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
 - vii. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjore të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.
 - viii. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlerësim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 - ix. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlerësim paraprak të metodologjisë pranë Autoritetit të Konkurrencës.
 - x. Detyrimet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 9 duhet të përmbushen brenda afatit 120 ditor nga dita që ky vendim i është njoftuar.
 - xi. Në rast të mos përmbushjes së kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në dispozitivin e këtij vendimi, FSHF ndëshkohet me gjobë deri në 5 % të xhiros mesatare ditore për shkelje të rëndë të konkurrencës në zbatim të nenit 76, pika 1, germa (a) të ligjit nr. 9121/2003.
 - xii. Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 2 vjeçare.
6. Autoriteti i Konkurrencës në kuadër të monitorimit të zbatimit të kushteve dhe detyrimeve sipas vendimit nr. 693, datë 14.05.2020, ka kryer korrespondencën si më poshtë vijon:
- AK me shkresën nr. 52 prot., datë 19.01.2022 “Mbi zbatimin e VKK nr. 693, datë 14.05.2020”, drejtuar FSHF, ka kërkuar informacionin mbi zbatimin e kushteve dhe detyrimeve sipas VKK nr. 693/2020.
 - FSHF me shkresën nr. 220 prot., datë 02.02.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/1 prot., datë 03.02.2022) “Kthim përgjigje mbi shkresën nr. 52 prot., datë 19.01.2022 “Mbi zbatimin e VKK nr. 693, datë 15.05.2020” dhe me shkresën nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, na informon në lidhje me zbatimin kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara ne VKK nr. 693/2020, si më poshtë vijon:

i. Detyrimin e FSHF që shitja e përbashkët e së drejtës televizive, si një e drejtë ekskluzive në të ardhmen të reduktohet në fushëveprim dhe kohëzgjatjen e ekskluzivitetit, në një periudhë jo më shumë se 3 (tre) vjet, ku të drejtat të jenë të ndara dhe t'u shiten operatorëve të ndryshëm.

FSHF me shkresën nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, ka informuar se nëpërmjet Ftesës për dhënie oferte për “Shitjen e të drejtës së transmetimit të kampionatit “Abissnet Superiore”, Kupa e Shqipërisë, Super Kupa dhe Kategoria e Parë”, për territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, ka ftuar të gjithë të interesuarit për të paraqitur ofertën ose ofertat e tyre ekonomike për shitjen e të drejtës televizive për garat e organizuara prej saj, për një periudhë 3 (tre) vjeçare në sezonet 2022-23; 2023-24 dhe 2024-25, të cilat duhet të shoqërohen me specifikimet teknike dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden Ftesa për dhënie oferte për “Shitjen e të drejtës së transmetimit të kampionatit “Abissnet Superiore”, Kupa e Shqipërisë, Super Kupa dhe Kategoria e Parë” për territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës si dhe specifikimet teknike dhe dokumentacionin e nevojshëm, ku në “pikën V “Ofertat sipas paketave”” gjenden të ndara paketat për tu ofertuar, si më poshtë vijon:

1. Kampionati Abissnet Superiore (Paketa A, Paketa B, Paketa C dhe Paketa D);
2. Kupa e Shqipërisë dhe Super kupa e Shqipërisë;
3. Kategoria e Parë.

Për sa më sipër, pika “2.a” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke reduktuar kohëzgjatjen e ekskluzivitetit në një periudhë 3 (tre) vjeçare si dhe janë ndarë paketat në tre kategori për t’ju ofertuar operatorëve të ndryshëm.

ii. Detyrimin e FSHF në të ardhmen të ndajë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë”, me dallimin në ofertë me paketën A (ndeshjet kryesore, të rëndësishme) dhe B (ndeshjet e tjera), në mënyrë që ato të mos i përkasin një operatori të vetëm, duke siguruar një pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve audioviziv.

FSHF me shkresën nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, ka informuar se ka ndarë veç paketat për Kategorinë Superiore (*Kampionati Abissnet Superiore (Paketa A, Paketa B, Paketa C dhe Paketa D)*) dhe veç paketat për Kupën e Shqipërisë (Kupa e Shqipërisë dhe Super kupa e Shqipërisë) siç provohet nga aneksi nr. 2 bashkëlidhur kësaj shkrese “Specifikimet teknike, pika V “Ofertat sipas paketave””.

Për sa më sipër, pika “2.b” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke ndarë prokurimin e dy kategorive “Kategorinë Superiore” dhe “Kupën e Shqipërisë” dhe duke siguruar një pjesëmarrje më të madhe të operatorëve audioviziv.

iii. Heqjen e ekskluzivitetit në të ardhmen në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “Highlighte” dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të gjerë për operatorët audioviziv.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, shpjegon se janë kujdesur që të gjithë konkurruesit në garën për të drejtën televizive ti bëjë me dije se “Highlights” nuk do të jenë ekskluzive dhe do ti ofrohen për blerje të gjithë operatorëve të interesuar.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden dhe kontratat e licensimit të lidhura me ndërmarrjet Telesport SHA dhe Focus Media News SHPK, ku FSHF i ka dhënë të drejtën për të transmetuar “Highlighte”, në platformat News 24 dhe Telesport si dhe këto të drejta janë jo ekskluzive.

Për sa më sipër, pika “2.c” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, pavarësisht se nga Komisioni i Konkurrencës nuk është vendosur një afat i përcaktuar në lidhje me zbatimin e kësaj pike, FSHF ka hequr ekskluzivitetin në kontratat e shitjes së të drejtave audiovizive “Highlighte” dhe ka krijuar mundësinë për pjesëmarrje më të gjerë për operatorët audioviziv.

iv. Përfshirjen e Ligës Profesioniste duke i dhënë asaj një rol aktiv në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtë televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 220 prot., datë 02.02.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/1 prot., datë 03.02.2022) “Kthim përgjigje mbi shkresën nr. 52 prot., datë 19.01.2022 “Mbi zbatimin e VKK nr. 693, datë 15.05.2020” dhe shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, ka njoftuar se në procedurat e zhvilluara në vitin 2021 (moment kohor pas marrjes së Vendimit të Komisioni të Konkurrencës nr. 693, datë 14.05.2020) për përzgjedhjen e sponsorit të Kategorisë Superiore, ka qenë pikërisht Liga Profesioniste dhe anëtarët e saj (Presidentet e Klubeve) që kanë ndjekur gjithë procedurat e tenderimit duke marr ofertimet nga operatorë të ndryshëm në treg, diskutimit dhe finalizimin e kontratës me subjektin përkatës që është përzgjedhur. Si dhe ka informuar se përpara realizimit të procedurës së prokurimit mbi shitjen e të drejtës televizive është bërë konsultimi me Ligën Profesioniste të Futbollit përmes Sekretarit të Përgjithshëm duke u përfshirë në proceset konsultuese për shitjen e të drejtës televizive për tre sezonet e ardhshme, siç provohet dhe nga shkresa bashkëlidhur e Ligës Profesioniste të Futbollit.

Për sa më sipër, pika “3” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke i dhënë një rol aktiv Ligës Profesioniste me përfshirjen në çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me “shitjen e përbashkët të së drejtë televizive”, si dhe të drejtave të tjera që burojnë prej saj.

v. Detyrimin e FSHF për shpërndarjen e fondeve të ardhura me destinacion të përcaktuar nga UEFA, FIFA etj., në një procedurë transparente dhe korrekte, në prani të Ligës Profesioniste, në mënyrë që të ruhet konkurrenca e ndershme dhe efektive në treg. Kjo procedurë të bëhet publike në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 220 prot., datë 02.02.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/1 prot., datë 03.02.2022) “Kthim përgjigje mbi shkresën nr. 52 prot., datë 19.01.2022 “Mbi zbatimin e VKK nr. 693, datë 15.05.2020” dhe shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022

(protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, ka shpjeguar se fondet FIFA dhe UEFA nuk vijnë me destinacion të përcaktuar por këto fonde vijnë për dy shtylla kryesore të aktivitetit të FSHF. E para për financimin e administratës së FSHF dhe e dyta për projekte të caktuara, qofshin këto në infrastrukturë sportive, në projekte për fëmijët, në rritjen e futbollit të femrave, etj., në të cilat aplikohet sipas procedurave të shpallura prej vetë konfederatave europiane (UEFA) dhe botërore (FIFA).

Mënyra e përfitimit të kontributeve nga këto organizata me qëllim të zhvillimit, promovimit dhe organizimit të futbollit në përgjithësi, përcaktohet nga rregullore përkatëse të cilat janë publike. Të gjitha Federatat i nënshtrohen auditimeve vjetore të pavarura të pasqyrave të tyre financiare, nga këto organizata për të siguruar që fondet e ardhura të llogariten dhe të drejtohen ekskluzivisht për destinacionet e ardhura.

Për sa më sipër, pika “4” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke realizuar shpërndarjen e fondeve të ardhura nga FIFA dhe UEFA të cilat auditohen dhe kontrollohen dhe nga vetë këto organizata si dhe rregullat për aplikimin dhe përfitimin e tyre janë të publikuara në faqet zyrtare të këtyre organizatave.

vi. Detyrimin për zbatimin e një procedure transparente për zgjedhjen e sponsorit kryesor dhe sponsorëve të tjerë, duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të ndërmarrjeve në treg. Kjo procedurë të bëhet publik në faqen zyrtare të FSHF – www.fshf.org.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, është shprehur se komiteti ekzekutiv i FSHF ka miratuar një udhëzues për Kategorizimin dhe Procedurën e Përzgjedhjes së Sponsorëve të FSHF. Ky dokument i publikuar në faqen zyrtare të FSHF është hartuar me qëllimin strukturimin dhe mirë përcaktimin e procesit të përzgjedhjes së sponsorëve të FSHF dhe përmban hapat që ndiqen, analizat që kryhen, dhe përgjegjësitë përkatëse për kategorizimin dhe përzgjedhjen e sponsorëve të FSHF. Ky dokument gjithashtu strukturon procedurat që duhet të ndjekë Sekretariati i Përgjithshëm i FSHF për të implementuar siç duhet kontrollet e brendshme për përcaktimin e marrëdhënieve të sponsorizimit, dhe shërben si një guidë për gjithë proceset mbështetëse të lidhura me këtë proces. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet edhe udhëzuesi “Për kategorizimin dhe procedurën e përzgjedhjes së sponsorëve të Federatës Shqiptare të Futbollit”, i cili është publik dhe në faqen zyrtare të FSHF.

Për sa më sipër, pika “5” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke miratuar një udhëzues për Kategorizimin dhe Procedurën e Përzgjedhjes së Sponsorëve të FSHF e cila është e publikuar dhe në faqen zyrtare të FSHF.

vii. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

viii. Detyrimin e FSHF për shmangien e çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis përfaqësuesve ligjore të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë shoqërisë

DIGITALB, lidhje të cilat ndikojnë në kufizimin apo shtrembërimin e konkurrencës, të krijuar për shkak të pozitës së saj dominuese.

Referuar shkresës nr. 77 prot., datë 31.01.2022 “Mbi transaksionin e njoftuar në lidhje me blerjen e aksioneve në shoqërinë Digit-Alb SHA” dhe ekstraktit historik të ndërmarrjes Digit-Alb SHA, është konstatuar që ka ndodhur ndryshimi në strukturën e aksioneve pranë kësaj ndërmarrje. Ky ndryshim ka rezultuar në këtë strukturë aksionesh: Z. A.Z ka lëshuar kuotat dhe zotëron 0% të aksioneve të ndërmarrjes Digit-Alb SHA, ndërmarrja A.I.B.A. Kompani me aksionar të vetëm Z. A.D ka lëshuar kuotat dhe zotëron 0% të aksioneve të ndërmarrjes Digit-Alb SHA.

Për sa më sipër, pika “6 dhe 7” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke lëshuar aksione pranë shoqërisë Digit-Alb SHA, për të shmangur çdo lloj lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasurore, midis sponsorizuesve të saj, përfaqësuesve ligjore të saj dhe përfaqësimit pasuror pranë kësaj shoqërie.

ix. Detyrimin e FSHF në të ardhmen për lidhjen e çdo kontrate që vendos të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ndërmarrje ose produkte të caktuara, të realizojë procedura prokurimi transparente, jo diskriminuese duke mos vendosur kriteret kufizuese dhe përjashtuese në tregun përkatës. Këto kontrata të sillen për vlerësim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, në kuadër dhe të zbatimit të pikës “2.a” të dispozitivit të VKK nr. 693/2020 ka depozituar pranë AK “Ftesa për dhënie oferte për “Shitjen e të drejtës së transmetimit të kampionatit “Abissnet Superiore”, Kupa e Shqipërisë, Super Kupa e Shqipërisë dhe Kategoria e Parë”, për territorin e Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës, nëpërmjet të cilës FSHF kërkon të shesë të drejtën televizive për garat futbollistike për territoret e Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për një periudhë 3 (tre) vjeçare si dhe specifikimet teknike dhe dokumentacionin e nevojshëm që të gjithë të interesuarit duhet të paraqesin në ofertën ose ofertat e tyre ekonomike.

Për sa më sipër, pika “8” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke njoftuar pranë Autoritetit të Konkurrencës së ka nisur garën për shitjen e të drejtës televizive të “Abissnet Superiore”, Kupa e Shqipërisë, Super kupa e Shqipërisë dhe Kategoria e Parë dhe në përfundim të kësaj procedure do të sillen kontrata për vlerësim paraprak pranë Autoritetit të Konkurrencës.

x. Detyrimin e FSHF të hartojë një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave, me qëllim orientimin drejt kostos të shërbimit dhe çmimit të biletave. Sjelljen për vlerësim paraprak të metodologjisë pranë Autoritetit të Konkurrencës.

FSHF nëpërmjet shkresës nr. 1103 prot., datë 12.07.2022 (protokolluar pranë AK me nr. 52/2 prot., datë 13.07.2022) “Mbi zbatimin e vendimit nr. 693, datë 15.05.2020 i Komisionit të Konkurrencës”, është shprehur se ka implementuar një metodologji për përcaktimin e çmimit të biletave për secilën kategori ndeshjesh, metodologji e cila tani zbatohet nga FSHF.

Metodologji e cila është depozituar dhe pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe është vlerësuar se nuk kufizon ose pengon konkurrencën në kuptim të ligjit nr. 9121/2003.

Për sa më sipër, pika “9” e dispozitivit të VKK nr. 693, datë 15.05.2020 është zbatuar nga FSHF, duke hartuar dhe implementuar një metodologji për përcaktimin e çmimeve të biletave si dhe duke e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës për vlerësim paraprak.

7. Si përfundim, sa më sipër, kushtet dhe detyrimet të dhëna në pikën 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 të vendimit nr. 693, datë 15.05.2020, janë zbatuar nga FSHF.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa (d) dhe nenin 26 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,


VENDOSI:


- I. Mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të vendimit nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA
()
Zv/Kryetar

Rezana KONOMI
()
Anëtar

Adriana BERBERI
()
Anëtar

Durim KRAJA
()
Anëtar

